REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-639
Data/Datum/Date: 08/05/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -5-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 91/2026
Datë: 08/05/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11, nenit 29 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenin 10 (paragrafi 7) të Rregullores Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Deklarata e Performancës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vitin 2025.
2. Deklarata e Performancës publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Institutit të Mjekësisë Ligjore.
3. Obligohet Njësia Përgjegjëse të dërgojë një kopje të Deklaratës së Performancës në Sekretariatin Koordinues të Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Anëtarëve të Njësisë përgjegjëse për mbikëqyrje të Performancës së Institutit të Mjekësisë Ligjore;*
- *Drejtorit të Institutit të Mjekësisë Ligjore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*

Data:	08.05.2026
AGJENCIA	INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	MINISTRIA E DREJTËSISË
Aprovimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2025, rezulton se objektivat dhe treguesit e planifikuar janë realizuar pjesërisht. Andaj bazuar në këtë, mund të konsiderohet se Raporti i Performancës **miratohet pjesërisht (Po)**, me domosdoshmërinë për përmirësime në fusha specifike.

Vlerësimi përshkrues i Performancës

Instituti i Mjekësisë Ligjore ("IML") në kuadër të Planit të Përformancës për vitin 2025 ka paraparë, katër objektiva dhe 15 aktivitete. Në bazë të vlerësimit të përgjithshëm IML ka realizuar pjesërisht këtë plan.

Vlerësimi i përgjithshëm i realizimit të këtij Plani tregon një progres të pa balancuar, me arritje të rëndësishme në disa fusha kyçe por edhe me dështime apo ngecje të dukshme në anën tjetër, që janë thelbësore për funksionimin e plotë të IML.

Në aspektin pozitiv, modernizimi i infrastrukturës përben suksesin më të madh të vitit 2025. Investimet në renovim, përmirësimin e kushteve teknike, sigurisë dhe organizimit të brendshëm kanë krijuar bazën për një institucion që i afrohet standardeve ndërkombëtare. Kjo objektivë mund të konsiderohet e përmbushur dhe me ndikim afatgjatë pasi krijon parakushte për zhvillim te mëtejmë profesional dhe operacional. Megjithatë, ky progres është shoqëruar me kosto të konsiderueshme operacionale. Vonesat në renovim kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mos funksionalizimin e laboratorëve.

Në këtë drejtim, mund të konkludohet se janë vendosur themele të rëndësishme për zhvillim afatgjatë (sidomos në infrastrukturë), mirëpo mungesa e stabilitetit institucional, vonesat në vendimmarrje dhe dobësitë në menaxhimin e projekteve kanë penguar arritjen e rezultateve të plota.

Për të ecur përpara, është thelbësore që IML të konsolidojë strukturën drejtuese, të përshpejtojë funksionalizimin e kapaciteteve laboratorike, të rrisë llogaridhënien në realizimin e objektivave dhe të fokusohet në zbatimin konkret të shërbimeve për qytetarët. Vetëm në këtë mënyrë investimet e bëra mund të përkthehen në rezultate reale dhe të qëndrueshme.

Fushat me performancë të mirë

Në kuadër të fushës me performancën me të mirë hyn objektiva "**Modernizimi i hapësirave të IML-se**, e cila përfshinë rinovimin e hapësirave kryesore (zyra, laboratorë, dhoma ekzaminimi, arkivë), përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe higjienës, si dhe instalimin e sistemeve moderne të ventilimit, ndriçimit, alarmit dhe mbrojtjes nga zjarri. Janë krijuar ndarje funksionale me kontroll qasjeje, duke rritur sigurinë dhe duke parandaluar

kontaminimin e kryqëzuar. Po ashtu, janë përmirësuar kushtet për personelin dhe palët, përfshirë hapësira të dedikuara për familjarët, policinë dhe studentët.

Riorganizimi i sistemit të ventilimit ka mundësuar funksionalizimin dhe licencimin e pajisjeve të radioskopisë. Janë realizuar gjithashtu: krijimi i arkivës qendrore, përmirësimi i dhomës së serverëve dhe sigurimi i diskrecionit në ekzaminimet e personave të gjallë. Ndërhyrje janë bërë edhe në sistemin e kanalizimit dhe largimit të ujërave, duke adresuar probleme të kahershme infrastrukturore. Në tërësi, kjo objektivë konsiderohet e përmbushur.

Gjithashtu, te performanca e mirë hyn objektiva" **Ngritja e kapaciteteve të stafit** ", ku gjatë vitit 2025 u realizuan trajnime në dy fusha kryesore:

- Mbrojtja nga zjarri (42 pjesëmarrës, në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike);
- Certifikimi i shkakut mjekësor të vdekjes (18 pjesëmarrës, me mbështetje të TAIEX).

Prioritetet për përmirësimin e performancës

Objektivat **"Përmirësimi i shërbimeve dhe transparencës dhe "Funksionalizimi i Laboratorit të Toksikologjisë"** nuk janë realizuar për tashme dy vite (2024-2025) dhe të njëjtat janë bartur edhe për vitin 2026 **".**

Andaj, me qëllim të përmirësimit të performances së IML-së rekomandohet të ndërmerren hapat si në vijim :

- Sigurimi i stabilitetit institucional- emërimi i drejtorit të përgjithshëm;
- Hartimi i Planit të ri Strategjik për IML;
- Funksionalizimi i Laboratorit të Toksikologjisë;
- Digjitalizimi i shërbimeve (ndërlidhja me e-Kosova);
- Rritja e transparencës përmes publikimit të dokumenteve;
- Zhvillimi i kapaciteteve dhe kompletimi i stafit.

Përmbushja e këtyre prioriteteve do të mundësojë funksionim të qëndrueshëm të IML-së.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

DEKLARATA E PERFORMANCES

Data:	10.04.2026
AGJENCIA	**AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE KONFISKUAR**
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	**MINISTRIA E DREJTËSISË**
Miratimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	Nga të dhënat e raportuara për vitin 2025 rezulton se shumica e objektivave dhe treguesve të planifikuar janë realizuar me sukses. Përjashtim bëjnë aktivitetet që lidhen me konkurset, të cilat nuk janë realizuar për shkak se nuk kanë qenë nën menaxhimin e drejtpërdrejtë të njësisë përkatëse. Në këtë kontekst, mund të vlerësohet se Raporti i Performancës miratohet (Po), duke reflektuar nevojën për avancim të mëtejshëm.
Vlerësimi përshkrues i Performancës	
Raporti analizon objektivat strategjike të Agjencisë, të cilat janë formuluar sipas parimit SMART (Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, Relevante dhe i Përcaktuar në Kohë). Për të siguruar një vlerësim të saktë të performancës, janë përcaktuar tregues të matshëm dhe burime të dedikuara për realizimin e tyre. Vlen të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e objektivave është realizuar plotësisht, ndërsa disa të tjera janë përmbushur pjesërisht. Për më tepër, Raporti evidenton harmonizimin e këtyre objektivave me prioritetet strategjike të Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë, duke garantuar një përputhje institucionale dhe një kontribut të drejtpërdrejtë në përmbushjen e mandatit të Agjencisë.	
Fushat me performancë të mirë	
Raporti evidenton disa fusha ku performanca ka qenë e lartë dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme. Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit, realizimi i objektivave strategjike dhe koordinimi institucional janë ndër aspektet më të suksesshme të procesit. Gjithashtu, përkushtimi dhe angazhimi i zyrtarëve të Agjencisë në implementimin e strategjive të reja	

menaxheriale ka ndihmuar në rritjen e efektivitetit operacional dhe në forcimin e kapaciteteve administrative.

Prioritetet për përmirësimin e performancës

Megjithëse progresi i bërë është i dukshëm, raporti identifikon disa sfida që duhet adresuar për të përmirësuar më tej performancën institucionale:

- **Krijimi i një sistemi efektiv të kontrollit të performancës:** Sugjerohet implementimi i një paneli të përditësuar të monitorimit, i cili do të mundësojë ndjekjen në kohë reale të progresit të objektivave. Pavarësisht se një matricë për vlerësimin e performancës është propozuar më parë, nuk është vënë ende në zbatim.

- **Përmirësimi i procesit të njoftimit dhe koordinimit ndërinstitucional:** Është e nevojshme të sigurohet një komunikim më i efektshëm midis njësisë përgjegjëse dhe stafit të AAPSK-së për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike, ku në këtë mënyrë do të shmanget vonesat, pra njoftimi në kohë reale i njësisë përgjegjëse për vlerësimin e performances.

Andaj, zbatimi i plotë i rekomandimeve do të mundësojë përmirësimin e mëtejshëm të mekanizmave të menaxhimit të performancës. Ndërsa sfidat ekzistojnë, është e rëndësishme që bashkëpunimi ndërmjet njësive të forcohet për të adresuar dhe eliminuar mangësitë.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë